



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLAĐA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUDJËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive
Nr./Br.No. 3321
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 4
Datum/Date: 10.08.2023
PRISHTINË PRISTINA PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-287/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Polux i prodhuesit “Galenika Fitofarmacija a.d”, Serbi nga përfaqësuesi i saj “Agrohëlp-SA SH.P.K”, Rahovec.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Insekticid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Deltamethrin.....25g/l

4. PËRDORIMI:

POLUX është insekticid jo-sistemik me veprim kontakti dhe digjestiv, me spektër të gjerë veprimi. Përdoret në:

1) plantacionet e mollës për kontrollin:

- krimbit të mollës (*Cydia pomonella*), në përqendrim 0,02- 0,03% (2-3 ml në 10 l ujë), trajtohet në fillim të çeljes së larvave të para.

- morrit të miellëzuar (*Dysaphis plantaginea*, *D. devector*),

në përqendrim 0,02- 0,03% (2-3 ml në 10 l ujë), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

- minatriqet e rumbullakëta (*Cemiostoma scitella*), minatriqet e bardha (*Lithocolletis corylifoliella*), minatriqet me pikëza (*L. blancardella*) dhe minatriqet e pemëve (*Lyonetia clerkella*), në përqendrim 0,03-0,05% (3-5 ml në 10 l ujë), trajtohet në kohën e fluturimit të fluturës dhe fillimi i çeljes së larvave (formimi i vrimave të para)

- grerëzës së mollës (*Hoplocampa testudinea*), në përqendrim 0,03-0,05% (3-5 ml në 10 l ujë), trajtohet para çeljes së larvave (faza 67-68 BBCH-shkalles)

2) plantacionet e dardhës për kontrollin:

- psillen e thjeshtë të dardhës (*Cacopsylla pyri*), në përqendrim 0,05% (5 ml në 10 l ujë), trajtohet kur regjistrohet prania e dëmtuesit.

- grerëzën e dardhës (*Hoplocampa brevis*), në përqendrim 0,03-0,05% (3-5 ml në 10 l ujë), trajtohet para çeljes se larvave (faza 67-68 BBCH-shkalles)

- morrin e dardhës (*Dysaphis pyri*) në përqendrim 0,02- 0,03% (2-3 ml në 10 l ujë), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

3) plantacionet e pjeshkës për kontrollin:

- morrit të pjeshkës (*Myzus persicae*, *M. varians*), morrin e kumbullës (*Hyalopterus pruni*), *Brachycaudus persicae* и *B. schwartzii* në përqendrim 0,03-0,05% (3-5ml në 10 l ujë), trajtohet me paraqitjen e kolonive të para.

- për kontrollin e krimbit të pjeshkës (*Cydia molesta*), në përqendrim 0,05% (5ml në 10 l ujë) trajtohet në kohën e shpimit të larvave të biskut.

4) plantacionet e qershisë dhe vishnjës për kontrollin:

- mizës së qershisë (*Rhagoletis cerasi*), në përqendrim 0,07% (7 ml në 10 l ujë), në kohën e paraqitjes së imagoëve të para dhe në fillim të çeljes së larvave.

- morrin e pjeshkës (*Myzus persicae*, *M. varians*), morrin e qershisë (*M. cerasi*), *Brachycaudus helichrysi*, *B. cardui*, *B. persicae* dhe *B. schwartzii*, në përqendrim 0,03-0,05% (3-5 ml në 10 l ujë), trajtohet me paraqitjen e kolonive të para.

5) plantacionet e kumbullës për kontrollin:

- grerëzës së verdhë (*Hoplocampa flava*) dhe zezë (*Hoplocampa minuta*) шљивине oce në përqendrim 0,03-0,05% (3-5ml në 10 l ujë), trajtohet menjëherë pas lulëzimit (faza 67-69 BBCH-shkalles)

- morrin e kumbullës (*Hyalopterus pruni*), *Brachycaudus helichrysi* morrave të gjetit të melit (*Phorodon humuli*), në përqendrim 0,03-0,05% (3-5ml në 10 l ujë), trajtohet me paraqitjen e kolonive të para.

6) plantacionet e mjedrës për kontrollin e mizës së ullinjve (*Dacus oleae*), në përqendrim 0,03-0,05% (3-5ml në 10 l ujë), trajtohet në kohën e fluturimit të mizës (nga mesi i qershorit deri në fund të gushtit).

7) plantacionet e hardhisë së rrushit për kontrollin tenje së përhimë (*Lobesia botrana*) dhe verdhë të hardhisë (*Eupoecillia ambiguella*), në përqendrim 0,03-0,04% (3-4ml në 10 l ujë) për gjeneratën e parë dhe në përqendrim 0,05- 0,07% (5-7 ml në 10 l ujë) për gjeneratën e dytë. Koha e përdorimit: 10-14 ditë pas zënies maksimale të fluturave me gracka të feromoneve apo në fillim të çeljes se larvave.

8) plantacionet e pyjeve për kontrollin: grerëzës kërcëllitëse të gjetheve të ahut (*Apotimus spp.*), tenjën e vogël dimërore (*Operophtera brumata*), barkartën (*Euproctis chrysorrhoea*), fluturën e madhe teke të dimrit (*Hibernia defoliaria*), disparin (*Lymantria dispar*) mbështjellësin e gjelbër të ahut (*Tortrix viridiana*), trajtohet nga toka në sasi 0,4 l/ha + 10 l/ha naftë (D1) apo trajtimi nga ajri në sasi 0,2 l/ha + 2,8 l/ha naftë (D1). Koha e përdorimit: trajtohen larvat e disparit të klasës së I dhe II, në kohën e çeljes masive të larvave; dëmtuesit tjerë gjatë paraqitjes maksimale të fluturave dhe vendosjes së vezëve apo në kohën e çeljes se larvave.

9) plantacionet e melit për kontrollin e morrave të gjetheve të melit (*Phorodon humuli*), në përqendrim 0,04-0,06% (4-6 ml në 10 l ujë), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

10) kulturat e drithërave për kontrollin:

- morrave të gjetheve (*Macrosiphum avenae*, *Metopolophium dirhodum*, *Rhopalosiphum padi*, *Schizaphis graminum*), në sasinë e përdorimit 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

- ushunjëzës së drithërave (*Oulema melanopus*), në sasinë e përdorimit 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet në kohën e paraqitjes së insekteve të rritura (imagove).

11) **kulturën e misrit për kontrollin** e krimbit të misrit (*Ostrinia nubilalis*), në sasi 0,4-0,5 l/ha (4-5 ml në 100 m²), trajtohet 10-14 ditë pas fluturimit maksimal të fluturave.

12) **kulturën e patates për kontrollin:**

- buburrecit të patates (*Leptinotarsa decemlineata*), në sasi 0,3 l/ha (3 ml në 100 m²), trajtohet para zhvillimit të larvave të klasës së katërt.

- morrin e gjetheve të pjeshkës (*Myzus persicae*), në sasi 0,3-0,5 l/ha (3-5 ml në 100 m²), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

13) **kulturën e domates për kontrollin:**

- krahëbardhën e serrave (*Trialeurodes vaporariorum*), në përqendrim 0,05% (5 ml në 10 l ujë), trajtohet gjatë paraqitjes së larvave të para.

- morrin e gjetheve të pjeshkës (*Myzus persicae*), në sasi 0,3-0,5 l/ha (3-5 ml në 100 m²) trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

14) **kulturën e kastravecit** për kontrollin krahëbardhës së serrave (*Trialeurodes vaporariorum*), në përqendrim 0,05% (5 ml në 10 l ujë), trajtohet gjatë paraqitjes së larvave të para.

15) **kulturën e panxharsheqerit** për kontrollin:

- lule ngrënësin e kolzes (*Meligethes aeneus*), në sasi 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet në fillim të paraqitjes, në kohën e formimit të luleve të para e deri para lulëzimit

- grerëzën e panxharit (*Athalia colibri*), në sasi 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet në fillim të çeljes së larvave.

16) **kulturën e duhanit** për kontrollin:

- tripsin e duhanit (*Thrips tabaci*), në sasi 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet nga paraqitja e tripsit, në lehe ose menjëherë pas trapiantimit.

- krimbat tel (*Agriotis sp.*), në sasi 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), kur dominojnë larvat e fazës së II dhe III të zhvillimit (1-2 larva për m²)

- morrat e gjetheve të pjeshkës (*Myzus persicae*), në sasi 0,2-0,3 l/ha (2-3 ml në 100 m²), trajtohet në fillim të formimit të kolonive të para.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

1L

6. VËREJTJE:

Ndalohet përdorimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve në zonat e mbrojtjes së ujit për burimet e ujit dhe furnizimin me ujë të popullsisë.

- Nuk duhet të aplikohet në kohën e fluturimit të bletëve.

- Mos e përdorni si alternativ këtë produkt me preparatet nga grupi i piretroideve, për shkak të zhvillimit të mundshëm të rezistencës kryqëzuar.

Papajtueshmëria (pamundësia të përzihet): Nuk lejohet të përzihet me supë Bordoleze, produktet me reaksion alkalike dhe sulfur.

7. KARENCA:

12 orë.



8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

GHS05-Paralajmërim për rrezikun-korroziv



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS08-i dëmshëm për shëndetin



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Faton Peci

për 
Ministër

Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.